REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**
**SENATI AKADEMIK**

Nr. 2536 Prot. 12 Vlorë më, 06.11.2024

**VENDIM**
**Nr. 61, datë 31.10.2024**
**PËR**
**HAPJEN E PROGRAMIT TË RI PROFESIONAL DY VJECAR TË STUDIMIT, "ASISTENCË NË GERIATRI" PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026 NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORË**

Në mbështetje të nenit 25, pika 7, 38, pika 1, shkronja dh, nenit 71, 72, të ligjit Nr.80/2015"*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",* nenit 10, pika 6, nenit 19, pika 1, shkronja ë, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr.1 të MAS datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe proçedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL-ve, degëve dhe njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e IAL-ve", VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", e ndryshuar, si dhe referuar propozimit të Departamentit të Infermierisë, si dhe relacionit të Zëvendësrektorit Akademik, përcjellë me shkresën 2463/3, prot, datë, 31.10.2024, Senati Akademik në mbledhjen e datës 31.10.2024,

**VENDOSI**

1. Të miratojë propozimin e Departamentit të Infermierisë, në Fakultetin e Shëndetit, për hapjen e programit të studimit "Asistencë në Geriatri", sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Zëvendësrektori Akademik, Drejtuesit e Fakultetit të Shendetit, si dhe Drejtoria e Edukimit e Ciklit të Parë dhe të Dytë të studimit.
3. Ky vendim i përcillet për miratim të mëtejshëm Bordit të Administrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

**Prof. Dr. Aurela Saliaj**

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288
Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al